

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. ALLTUN ÇELA

01/08/2019

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 04.01.2019 për subjektin e rivlerësimit, z. Alltun Çela, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 08.01.2019 vendosi:

Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Alltun Çela, kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupa gjyqësore e kryesuar nga znj. Pamela Qirko, znj. Genta Tafa (Bungo) relatore, znj. Xhensila Pine anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ndaj këtij vendimi, mund të ushtrohet ankimi pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.